



INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

AKR | AGJENCIA
KOMBËTARE
E RINISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE
NR. 1268 PROT., DATË 24.06.2024

AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË
NR. 534 PROT., DATË 24.06.2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË

DHE

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE

TIRANË

MË DATË 24.06 /2024

AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË (AKR), me adresë në rrugën “Naim Frashëri”, nr. 37, 1000, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga z. Geron Ibrahim, Drejtori i Përgjithshëm, veprimtaria e të cilit bazohet në ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë” dhe VKM nr. 681 datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, të organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR)”.

dhe

INSTITUTI I STATISTIKAVE (INSTAT), me adresë në Rr. “Vllazën Huta”, Ndertesa 35, Hyrja 1, 1017, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga znj. Elsa Dhuli, Drejtor i Përgjithshëm. veprimtaria e të cilit bazohet në ligjin nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare”.

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje shprehin vullnetin si më poshtë;

NENI 1

BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje hartohet në bazë të Ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”, Ligjit Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 681, datë 02.09.2020, “Për Mënyrën e Krijimit, të Organizimit e të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 692 datë 26 Tetor 2022 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit të Veprimit 2022-2029”.

NENI 2

QËLLIMI I BASHKËPUNIMIT

Qëllimi i bashkëpunimit ndërmjet palëve nënshkruese të kësaj marrëveshje është të përforcojnë, promovojnë dhe zhvillojnë bashkëpunimin e tyre reciprok, mbi bazën e barazisë dhe përfitimit të përbashkët në çdo fushë të kësaj marrëveshjeje.

NENI 3

OBJEKTIVAT E BASHKËPUNIMIT

1. Kjo marrëveshje synon të sigurojë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve nënshkruese në lidhje me shkëmbimin e të dhënave statistikore dhe studimore për rininë.

2. Palët nënshkruese marrin përsipër që në përputhje me interesat institucionale, mundësitë dhe kapacitetet përkatëse, të vendosin në dispozicion të njëra-tjetrës të gjitha burimet njerëzore dhe materiale për arritjen e qëllimeve që parashikon kjo marrëveshje.

NENI 4

FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

Fushat kryesore të bashkëpunimit janë:

1. Vënia në dispozicion të AKR, nga INSTAT, të informacionit statistikor për rininë, të publikuar online apo shkresor (botime).
2. Vënia në dispozicion të kapaciteteve që disponon INSTAT në organizimin e trajnimeve për rritjen profesionale të stafit të AKR-së në fushën e prodhimit statistikor.
3. Përfshirja e INSTAT-it nga ana e AKR-së në fushat e aktiviteteve që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore për vlerësimin e fenomeneve social-kulturore të grupmoshës së rinisë.

NENI 5

PRONËSIA INTELEKTUALE

Në rast se gjatë zbatimit të bashkëpunimit lindin të drejta të pronësisë intelektuale, palët do të specifikojnë cilës i takon pronësia intelektuale, bazuar në legjislacionin shqiptar për pronësinë intelektuale.

NENI 6

KONFIDENCIALITETI DHE KONFLIKTI I INTERESIT

1. Palët angazhohen të marrin të gjitha masat për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe informacionit për të cilin marrin dijeni gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje në respektim të nenit 31 të ligjit 17/2018 "Për statistikën zyrtare" dhe akteve të tjera ligjore në fuqi që mbrojnë të dhënat personale.
2. Në çdo rast bashkëpunimi i ndërsjellët gjatë kësaj marrëveshjeje do të udhëhiqet nga parimet e etikës profesionale dhe shmangies së konfliktit të interesit sipas legjislacionit në fuqi.

NENI 7

KOMUNIKIMI

Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm në të gjitha nivelet. Me qëllim përmbushjen e të gjithë objektivave të kësaj marrëveshje secila palë do të caktojë një person si koordinues për komunikimin midis tyre dhe përcjelljen e problematikave sipas rastit. Personat e kontaktit për secilën palë në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshje janë:

- a) Për AKR-në person kontakti është znj. Matilda Mullaraj, Përgjegjëse e Sektorit për Zbatimin e Politikave, Studimet dhe të Dhënat për Rininë , e-mail: matilda.mullaraj@rinia.gov.al.
- b) Për INSTAT-in person kontakti është znj. Elona Sevrani, Drejtoresha e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor, e-mail: esevrani@instat.gov.al.

NENI 8

KUFIZIMET E MARRËVESHJES

1. Të dyja palët bien dakord që realizimi i veprimtarive me interes të përbashkët kryhet në varësi të përparësive, planifikimit paraprak, burimeve dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion.
2. Për çdo veprimtari tjetër që përputhet me frymën e kësaj marrëveshje, palët kanë të drejtë të konkludojnë mbi mënyrën e realizimit të bashkëpunimit.
3. Kjo Marrëveshje bashkëpunimi nuk shoqërohet me detyrime apo impakt financiar ndërmjet palëve përveç rasteve kur palët bien dakord ndryshe me marrëveshje të veçantë.
4. Nëse nga bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve bazuar në parimet e mësipërme, lind nevoja për financimin e projekteve të përbashkëta, të dy institucionet do t'i rregullojnë këto raporte me marrëveshjeve të veçanta financiare të cilat do të jenë pjesë integrale të këtij bashkëpunimi.
5. Palët bien dakord që të ruajnë dhe të respektojnë integritetin reciprok.

NENI 9

NDRYSHIMI, AMENDIMI DHE REVOKIMI I MARRËVESHJES

1. Çdo nen i kësaj marrëveshje mund të ndryshohet, amendohet ose të revokohet në çdo kohë, pas

2. Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim dhe bashkëpunim mes palëve.

NENI 10
HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të palëve dhe do të shtrijë efektet për një periudhë kohore të pakufizuar. Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku të gjithë tekstet janë njëloj të vlefshëm. Secila nga palët mban një kopje në origjinal.

Për INSTAT

.....
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Znj. Elsa Dhuli

Për AKR

.....
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Z. Geron Ibrahim

